



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.10.2021

MBLEDHJA Nr. 48,
datë 08.10.2021, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 08.10.2021, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 48 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Voltalia s.a. dhe OST sh.a., për vlerësimin dhe pranimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen standard të lidhjes së miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE nr. 87, datë 20.4.2018
2. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE, të performancës së shërbimit ndaj klientit
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Hec Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Terfoja” me kapacitet të instaluar 1980 kW
4. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Hec Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike
5. Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-S nr. 187, datë 10.09.2021 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 85, seria pv09k, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Pure Energy Stebleva” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 19.08.2009”

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet

platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI